GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual **Faton Ademi**, me procesmbajtësen Elheme Peci në çështjen juridike të paditëses: e Sigurimeve me seli në Prishtinë të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson: , kundër të paditurit: nga fshati Komuna e Mitrovicës, baza e kontestit: Rimbursim dëmi, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 20.03.2018 bie këtë:

A K T GJ Y K I M

- **OBLIGOHET**, i padituri që paditëses t'ia kompensojë shumën prej 576 euro, në emër të rimbursimit të dëmit material të shkaktuar të dëmtuarit në aksidentin e datës: 12.09.2012, me kamat ligjore si për mjetet e depozituara në bankë pa destinim të caktuar të gjitha këto në afat 15 ditor nga data e pranimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm

- **OBLIGOHET**, i padituri që paditëses në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajë shumën prej 15 euro në emër të taksës për padi, ndërsa gjykatës t'ia paguajë taksën për përpilimin e aktgjykimit në shumë prej 15 euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga data e pranimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm

A r s y e t i m

Paditësi me datë: 18.11.2015 ka parashtruar në gjykatë padi për rimbursimin e dëmit, që rrjedh nga aksidenti i datës: 12.09.2012, kundër të paditurit.

Gjykata ka caktuar seacën kryesore me datën: 30.01.2018 në të cilën prezantoi: përfaqësuesja e paditëses ndërsa mungoi I padituri I cili ishte I ftuar me rregull dhe mungesën nuk e kishte arsyetuara.

Seanca u mbajt në mungesë të të paditurit.

Përfaqësuesja e paditësit në seancë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë për faktin se me administrimin e provave u vërtetua baza juridike e kërkespadisë andaj kërkojmë nga gjykata që e njëjta të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe ta obligoj të padituri që ta rimbursoj dëmin e shkaktuar në shumë prej 576 euro, me kamët ligjore që nga data e ngritjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedures ashtu siq janë të precizuara në petitumin e kërkespadisë.

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata administroi këto prova: ujdia jashtëgjyqesore e dt. 23.01.2013, urdhëresa e transferit e dt. 23.01.2013, tabela mbi transferin e mjeteve,3 fletë me fotografi nga të cilat është vështirë të shihet qartë dëmi I automjetit, procesverbali mbi dëmtimin e automjetit I dt. 21.09.2012, aktvlerësimi I dëmit I dt.

03.10.2012,paraqitja e dëmit e dt. 21.09.2012,kopja e letërnjoftimit dhe kartelës bankare të personit të tretë,vendimi I dt.06.12.2012 kopja e patent shoferit dhe libreza e automjetit të personit të tretë,polisa e sigurimit për automjetin e personit të tretë, raporti I aksidentit I dt. 12.09.2012 ,vendimi I komisionit të shkallës së parë për trajtimin e dëmeve I dt.06.12.2012,aktvendimi I Gjykatës komunale për kundërvajtje I dt. 07.11.2012,shkresa e dt.10.10.2012

Gjykata provat e administruara i vlerësoi një nga një dhe në raport me provat tjera, konform nenit 7 dhe 8 të LPK-së, ku nga provat e administruara vërtetoi këto fakte:

Për gjykatë nuk është kontestues fakti se i padituri në aksidentin e datës: 12.09.2012 ka qenë pjesmarrës në komunikacion pra ka drejtuar mjetin motorik Traktor , kjo vërtetohet në bazë të raportit të aksidentit.

Nuk është kontestues fakti se ditën kritike ditën kur ka ndodhë aksidenti mjeti motorik-traktor të cilin e ngiste tani i padituri nuk ka pasur sigurim, kjo vërtetohet në bazë të raportit të aksidentit të datës: 12.09.2012.

Se i padituri e ka shkaktuar aksidentin në fjalë gjykata këtë fakt e vërtetoi në bazë të raportit të policisë të datës: 12.09.2012, ku në këtë raport në përshkrimin e detajave të aksidentit dhe në skicën e aksidentit shihet qartë se I padituri me mjetin motorrik Traktor nga mbrapa ka goditur automjetin e personit si dhe automjetin e personit

Në aksidentin në fjalë janë ndeshur mjeti motorik i të paditurit dhe dy automjete tjera ku njëra ndër to automjeti i me targa të regjistrimit i cili automjet ka qenë i siguruar te kompania e sigurimeve krejt kjo vërtetohet në bazë të raportit të aksidentit dhe shkresave tjera.

Se paditësja dëmin e shkaktuar nga paditësi ia ka kompensuar personit të tretë ky fakt vërtetohet në bazë të ujdisë jashtëgjyqësore të datës: 23.01.2013, vendimi I datës: 06.12.2012, nga urdhëresa mbi transferin e mjeteve financiare në lartësi të objektit të kërkesëpadisë.

Paditësja dëmin e shkaktuar në automjet e vlerësuar në lartësinë sikurse në kërkesëpadi, pasi ashtu është konstatuar nga ana e ekspertëve të paditëses.

Se I padituri është shpallur fajtor për shkaktimin e aksidentit bashkë me drejtuesin tjetër të automjetit B këtë fakt gjykata e vërtetoi në bazë të Aktvendimit të Gjykaës Komunale për Kundërvajtje të datës: 07.11.2012 sipas të cilit I njëjti është dënuar me gjobë në lartësi prej 70 eurove.

Në raport me fotografitë e dëmit të automjeteve, gjykata vlerëson se ato si të tilla janë të pa shiqueshme sepse janë bërë kopje nuk dallohet pothuajse asgjë në to, mirëpo nga provat tjera të cekura si më lartë

vërtetohet sikurse paza e kërkesëpadisë e po ashtu edhe lartësia e të njëjtës.

Është e drejtë e paditëses që në mënyrë të lirshme pa kurrfar ndikimi dhe jo në mënyrë arbitrare të vlerëson secilin dëmë që i paraqitet për kompensim pasi e njëjta në rradhët e veta posedon eksperta të lamisë së makinerisë, andaj komisioni i paditëses e ka vlerësuar se dëmi real në automjetin që duhet kompensuar është shumë prej 576 euro sikurse shuma e cekur në padi dhe e aprovuar me këtë aktgjykim.

Baza juridike e kërkesëpadisë është në përputhje me dispozitën ligjore nenin 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Duke marrë për bazë këtë fakt dhe të cekurat më lartë, gjykata konsideron se padia dhe kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Gjykata, lidhur me caktimin e kamatës vjetore, u bazua në nenin 277, par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të aplikueshëm në rastin konkret, ndërsa, lidhur me lartësinë e saj, u bazua në lartësinë e mjeteve të deponuara në bankat afariste për një vit pa destinim të caktuar

Sa i përket shpenzime procedurale gykata u bazu në nenin 452 paragrafi i të LPK-së, ku pala e cila e ka humb kontestin duhet t'ia paguajë palës tjetër shpenzimet procedurale.

Aktgjykimi u mor konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.Nr.645/2015 datë: 20.03.2018

GJ Y Q T A R I
Faton Ademi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditor, nga dita e pranimit së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – nëpërmjet kësaj Gjykate.